

**AKT I THEMELIMI DHE STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
" DOME " SHPK**

**KREU I**

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

**NENI 1**

**EMRI I SHOQËRISË**

**1.1** Emri i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është " DOME " SHPK, këtu e më poshtë e quajtur "Shoqëria".

**NENI 2**

**SELIA**

**2.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Myrtesha Myrteveli", Hyrja 1, Apartamenti 35, Nr.Pasurie 2/72+1-35, Zona Kadastrale 8564, Korçë, Shqipëri.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**PERSONALITETI JURIDIK**

**3.1** Shoqëria është person juridik shqiptar.

**3.2** Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**3.3** Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

**NENI 4**

**FORMA E SHOQËRISË**

**4.1** Shoqëria do të ketë formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, derisa me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të vendoset ndryshimi i formës ligjore.

## **NENI 5**

### KOHËZGJATJA

5.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **NENI 6**

### VULA E SHOQËRISË

6.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emërtimin tregtar, logon ose iniciale.

## **NENI 7**

### OBJEKTI I SHOQËRISË

7.1 Shoqëria " DOME " SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

- Projektim arkitektonik për objekte civile, industriale, sportive, social kulturore vepra arti në infrastrukturë etj.
- Masterplane, studime e plane rajonale urbanistike.
- Studime pjesore urbanistike, Plane të Detajuara Vendore.
- Projektim interiori dhe eksteriori.
- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbëruara, lulishte e parqe.
- Veprimtari lizingu (qiradhënie).
- Veprimtari në fushën e transportit të mallrave.
- Blerje e tjetërsime të pasurive të luajtshme e të paluajtshme.
- Ndërtime të objekteve civile, industriale, sportive, shëndetësore dhe social-kulturore.
- Ndërtime të objekteve të infrastrukturës si rrugë, ujësjellësa, kanale, etj.
- Prodhimin e betonit, elementëve të parafabrikuar dhe paratensionuar, konstruksioneve metalike dhe mikste, dhe shitjen e tyre.
- Prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe tregëtimin e tyre.
- Drejtim punimesh dhe asistencë kantjeri me personel teknik të kualifikuar.
- Komisionim dhe ndërmjetësim në shitblerjet dhe dhëniet me qera të pronave të patundëshme (toka, apartamente, vila, godina civile e industriale, etj.).
- Vlerësim të objekteve të patundëshme në bazë të kostos së tyre në lidhje me tregun.
- Mbajtjen dhe aplikimin e të drejtës për komisionime në shitjen e materialeve të ndryshme, të aplikueshme në fushën e ndërtimit.
- Konceptimin dhe realizimin e reklamave ndriçuese, posterave, kartëvizitave, fletëpalosjeve, kalendarëve, guidave dhe llojeve të tjera të reklamimeve grafike të aktiviteteve të të tretëve dhe të vetë shoqërisë.

- Organizimin, menaxhimin dhe promovimin e eventeve dhe aktiviteteve sociale, kulturore dhe të biznesit në rang lokal dhe kombëtar.
- Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka të bëjë me objektivat e renditura sa më lart. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të ndërmarrë aktivitet tregtar, financiar, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet dhe përmbushet objekti i Shoqërisë. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të ngushtohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## 7.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektsh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;
- Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

**7.3** Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

## **KREU II**

### **KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

#### **NENI 8**

##### **KAPITALI I SHOQËRISË**

**8.1** Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (Njëqindmijë) Lek, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zotërojnë 100 % (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht si më poshtë:

Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
Marenglen Skëndi	50 %	1 kuotë
Artur Çakalli	50 %	1 kuotë

**8.2** Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota të zotëruar 50% nga ortaku i parë **Marenglen Skëndi** dhe 50% nga ortaku i dytë **Artur Çakalli** sipas tabelës më sipër.

- z. Marenglen Skëndi, shtetas shqiptar, i biri i Borisit, i datëlindjes 10.02.1975, lindur në Gjirokasrër dhe banues në Tiranë, Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati "Shallvare", Hyrja 3, Ap. 24, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr. BR6556288 e nr. personal H50210056N, i cili zotëron 50.0 % (pesëdhjetë presje zero për qind) të kapitalit.

- z. Artur Çakalli, shtetas shqiptar, i biri i Zanos, i datëlindjes 21.04.1975, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, Rruga "Teodor Keko", Nd. Romario 1, Hyrja 4, Ap. 31, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr. 034521937 e nr. personal H50421139V, i cili zotëron 50.0 % (pesëdhjetë presje zero për qind) të kapitalit.

**8.3** Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

**8.3** Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër ose në arkën e shoqërisë.

## **NENI 9**

### KUOTAT, TË DREJTAT E LIDHURA ME TO

**9.1** Çdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve.

## **NENI 10**

### FITIMI, TRANSFERIMI I KUOTAVE

**10.1** Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit, apo çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

## **NENI 11**

### KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

**11.1** Në rast se një ortak apo një bashkëzotëues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmet persona që do ti njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria; por asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

**11.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh

të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

**11.3** Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotërues i kuotës.

## **NENI 12**

### ZMADHIMI I KAPITALIT

**12.1** Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 14.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

**12.2** Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

**12.3** Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## **NENI 13**

### ZVOGËLIMI I KAPITALIT

**13.1** Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 14.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

**13.2** Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## **KREU III**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

## **NENI 14**

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

**14.1** Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

**14.2** Asambleja e Përgjithshme, si organ kryesor i shoqërisë sipas ligjit "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" përfaqësohet në këtë shoqëri nga ortakët.

**14.3** Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

**14.4** Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

**14.5** Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

**14.6** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

**14.7** Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

**14.8** Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

**14.9** Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

**14.10** Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

**14.11** Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për të vendosur për çështje të tilla si miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit të auditimit të shoqërisë.

**14.12** Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

**14.13** Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më sipër në nenin 14.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

## **NENI 15**

### **KOMPETENCAT E ASAMBLEË**

**15.1** Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. Ndryshimin e Statutit;
3. Emërimin/shkarkimin e Administratorit, ekspertëve kontabël, likuidatorëve;
4. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
5. Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
6. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
7. Kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj;
8. Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. Të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
10. Çështje të tjera që janë të rëndësishme për aktivitetin tregtar të shoqërisë.

## **NENI 16**

### **PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE**

**16.1** Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje, në rastet kur e ka të pamundur pjesëmarrjen personalisht në mbledhje, nga një person i tretë ose edhe nga një ortak tjetër shoqërie. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar qartë kompetencat e përfaqësuesit si dhe të drejtat e tij lidhur me vendimarrjen në mbledhje.

## **KREU IV**

### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

## **NENI 17**

### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**17.1** Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

**17.2** Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ja rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

**17.3** Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

**17.4** Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

**17.5** Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë:

- z. Artur Çakalli, shtetas shqiptar, i biri i Zanos, i datëlindjes 21.04.1975, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, Rruga "Teodor Keko", Nd. Romario 1, Hyrja 4, Ap. 31, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr. 034521937 e nr. personal H50421139V.

## **NENI 18**

### *SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT*

**18.1** Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

## **NENI 19**

### *PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT*

**19.1** Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) i përfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.
- f) sipas mënyrave të tjera parashikuar nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **NENI 20**

### *TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT, PËRGJEGJËSITË*

**20.1** Administratori ushtron kompetencat e mëposhtme:

1. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
2. Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në statut apo/dhe në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



3. Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë;
4. Jep urdhëra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
5. Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
6. Raporton para Asamblesë së Përgjithshme sa herë që Asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
7. Zbaton vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme;
8. Paraqet në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe përgjigjet për to;
9. Ushtron të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
10. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të ligjeve në fuqi.

## **KREU V**

### **KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENTI**

#### **NENI 21**

##### **KONTROLLI FINANCIAR**

**21.1** Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

#### **NENI 22**

##### **VITI FINANCIAR**

**22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

#### **NENI 23**

##### **BILANCI VJETOR**

**23.1** Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

**23.2** Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## **NENI 24**

### DIVIDENTI

**24.1** Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

**24.2** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividenti. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividenti.

## **KREU VI**

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

## **NENI 25**

### PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

**25.1** Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

## **NENI 26**

### LIGJI I ZBATUESHËM

**26.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

## **NENI 27**

### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

**27.1** Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Organet e Gjyqësorit të Republikës së Shqipërisë do të jenë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

## **NENI 28**

### NJOFTIMET

**28.1** Njoftimi për ortakët duhet të kryhet sipas adresave të përcaktuara në Nenin 8 të këtij statuti.

**28.2** Ortakët janë të detyruar të njoftojnë ndryshimet e adresave të tyre.

## NENI 29

### TË NDRYSHME


**29.1** Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky Akt Themelimi dhe Statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**29.2** Shoqëria "DOME" shpk regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 35 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"


**29.3** Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë juridike.

### THEMELUES

MARENGLËN SKËNDI



ARTUR ÇAKALLI



Pogradec, më 20. 05. 2021

